REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës:	2022:042516
Datë:	06.07.2022
Numri i dokumentit:	03205728

2022:106952

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, sipas gjyqtarit Habib Zeqiri - kryetar i trupit gjykues me asistimin e zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional, Sali Topalli, në çështjen penale kundër të pandehurve V.D, L.S dhe A.B, për shkak të veprës penale blerja posedimi, shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 261 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.I.nr.57/22 e datës 26.05.2022, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Rasim Maloku, të pandehurve: V.D, L.S dhe A.B dhe mbrojtëseve tyre, av. Mentor Neziri, av.Nysret Islami dhe av.Berat Peci, pas mbajtjes së seancës se shqyrtimit fillestar më 10 qershor 2022, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më 6 korrik 2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1. V.D, i lindur më ..., në Prishtinë, i biri A dhe nënës B., e gjinisë S., me vendbanim në rr.“....”, Prishtinë, ka te kryer shkollën e mesme, i martuar baba i një fëmije, me numër personal 1242521346, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. L.S, i lindur më ..., në Prishtinë, i biri F. dhe nënës L., e gjinisë O., me vendbanim në rr. ...., Prishtinë, ka te kryer shkollën fillore, i pa martuar me numër personal të letnjftimit, ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2022:106952

3. A.B, i lindur më .... në Prishtinë, i biri F. dhe nënës I., e gjinisë M., me vendbanim në rr. ..., BI, nr.1, Prishtinë, i pa martuar, ka te kryer shkollën fillore, i pa martuar, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse me datën 01 Mars 2022 rreth orës 20:05 në rrugën ..., Ferizaj, kanë poseduar pa autorizim, me qellim shitje dhe shpërndarje, substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuanë, në atë mënyrë që policia gjatë planit operativ "Zgjimi" nën dyshimin se i pandehuri L.S merret me shitblerjen e substancave narkotike, ndal për kontroll të pandehurin dhe tek i njëjti gjenden një qese me substanca narkotike të llojit marihuanë me peshë të përgjithshme 0.26 gram, e evidentuar si dëshmia D#A, më pas me pëlqimin e të pandehurit është kontrolluar banesa e tij, ku është gjetur një peshore digjitale dhe një qese me mbetje të substancës narkotike marihuanë, mirëpo deri sa i pandehuri gjendet në Stacionin Policor, në telefonin e tij mobil ka ardhur një sms përmes rrjetit social "Snap Chat" ku i kërkohej shitblerja e lëndës narkotike të llojit marihuanë, kështu që policia ka organizuar një plan operativ, në rrugën magjistrale Ferizaj-Prishtinë, ku është ndaluar vetuar "Mercedes E class", ngjyrë e zezë, me targa të huaja ..., pronë e të pandehurit V.D, mirëpo drejtuesi i veturës ka tentuar të ikë, mirëpo policia ka arritur që ta ndaloj dhe gjatë kontrrolit të veturës dhe të pandehurve V.D dhe A.B, ka gjetur një qese me substancë të llojit marihuanë, me peshë neto 44.64 gram, e evidentuar D#2, një qese marihuanë me peshë 1.17 gram, një qese me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 0.53 gram, e evidentuar si dëshmia D#3, një qese me substancë narkotike me peshë neto 0.64 gram, e evidentuar si dëshmia D#4, të cilat janë sekuestruar përkohësisht nga policia.

-Me të cilën në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerja posedimi, shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 261 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë nenit 374 par.1 dhe neneve 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69, 70, 71, 72, të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-ës, të pandehurit i;

G J Y K O N

2022:106952

Të pandehurin **V.D,** dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dëmi me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet me gjobë në lartësi prej 3000 € (tremijë euro) në te cilën dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim nga data 03.03.2022 deri më 10.06.2022 dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000 € (një mijë) euro .

Të pandehurin **L.S** dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dëmi me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet me gjobë në lartësi prej 2000 € (dymijë euro) në te cilën dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim nga data 03.03.2022 deri më 10.06.2022 dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind) euro.

Të pandehurin **A.B** dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dëmin me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet me gjobë në lartësi prej 2000 € (dymijë euro) në te cilën dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim nga data 03.03.2022 deri më 10.06.2022 dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000 € (një mijë) euro

Obligohen të pandehurit që dënimin me gjobë ta paguajnë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim burgimi ashtu që për çdo njëzet (20) € do ti llogaritet një ditë burgimi.

Konfiskohen në mënyrë të përhershme substanca narkotike e llojit marihuanë në peshën siç përshkruhen në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe pas plotfuqishmërisë urdhërohet shkatërrimi i lëndës narkotike.

U kthehen të pandehurve sendet e sekuestruara përkohësisht të pandehurve si në vijim:

-Të pandehurit **V.D:** Telefoni IPHONE 13 ngjyrë e zezë me kartelë, të hollat në shumë prej 3x20 €, 1x10 €, 3x5 €, 5x2 €, 2x1 € dhe 1x0.50 cent;

-Të pandehurit **L.S**: Telefoni IPHONE 8 PLUS-ngjyrë e bardhë, me kartelën e VALA-s me numër ....., dhe;

-Të pandehurit **A.B**: Telefoni IPHONE 11-ngjyrë e zezë, me kartelë numër .... dhe të hollat 3x100 €, 2x10 €, 2x5 €, 1x2 € dhe 6x1 €.

Obligohen të pandehurit veç e veç të paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për paushall nga 30 € (tridhjetë euro) dhe në emër të Fondit për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit

2022:106952

nga 50 € (pesëdhjetë euro) të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë, në të kundërtën do të urdhërohet përmbarimi i detyruar.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, ndaj të pandehurve V.D, L.S dhe A.B ka ngritur aktakuzën e evidentuar si PP.I.nr.57/22 e datës 26.05.2022, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerja posedimi, shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 261 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prokuroria e shtetit aktakuzës i ka bashkëngjit Marrëveshjen për pranimin e fajësisë, PP.I.nr.57/22 e datës 26.05.2022, deklaratën e te pandehurve V.D dhe L.S të datës 25.05.2022 të nënshkruar nga ana e te pandehurve, mbrojtësi i të pandehurit L.S av. Nysrtet Islami, mbrojtësi i të pandehurit V.D, av. Mentor Neziri, prokurori i shtetit dhe kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze në këtë gjykatë me datë 10 qershor 2022 ka mbajtur seancën shqyrtimin e marrëveshjen për pranimin e fajësisë të arritur me datën 25.05.2022, ne të pandehurit, mbrojtësit e tyre dhe prokurori shtetit u deklaruan përkitazi me marrëveshjen e pranimit të fajësisë duke i propozuar gjykatës pranimin e kësaj marrëveshje sipas kushteve të përcaktuara në ketë marrëveshje.

Gjykata me rastin e shqyrtimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për pranim të fajësisë ka konstatuar se marrëveshja është arritur dhe përpiluar me shkrim konform dispozitave të nenit 233 të KPP-së, andaj edhe marrëveshja si e tillë në tërësi është pranuar nga gjykata.

Sa i përket të pandehurit të pandehurit A. B në seancën e shqyrtimit fillestar mbajtur në të njëjtën ditë dhe kohë me seancën për vlerësimin e marrëveshjes për pranim fajësie për të pandehurit V.D dhe L.S, që do të thotë më 10 qershor 2022, i njëjti e ka pranuar fajsëinë për veprën penale për të cilën ngarkon akuza, i cili pranim është bërë konform nenit 248 par. 1 të KPPK-së pasi që i pandehuri ka kuptuar:

- natyrën dhe pasojat pranimit të fajësisë;
- pranimi është bërë vullnetarisht;

2022:106952

- mbështetet në faktet dhe në provat e çështjes si: si aktakuzë dhe fotot e tyre.
- se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, andaj kryetari i trupit gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit për tre të pandehurit.

Gjykata ka vlerësuar se në veprimet e të pandehurve formësohen të gjitha tiparet subjektive dhe objektive të veprës penale në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerja posedimi, shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 261 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, Gjykata pati parasysh që të gjitha rrethanat nga neni 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, si rrethana lehtësuese për të pandehurit Gjykata pati parasysh faktin e pranimit të fajësisë në seancën fillestare për të pandehurin A.B, respektivisht për të pandehurit V.D dhe L.S faktin se të njëjtit kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë, që do të thotë se të pandehurit pranimin e fajësisë e kanë bërë në fazën e hershme të procedurës, pendimin e tyre.

Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurve është në harmoni me peshën dhe përgjegjësinë penale të të pandehurve, duke konstatuar se edhe me këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i paraparë me neni 38 i KPRK-së, dhe se dënimi i shqiptuar do te ndikojë që të pandehurve në të ardhmen mos të kryej vepra penale, po ashtu dënimi i tillë do të ndikojë edhe si preventivë gjeneralë, duke ndikuar tek personat e tjerë që të parandalohen nga kryerja e veprës së tillë penale.

Konform nenit 374 par.3 të KPRK-ës Gjykata në mënyrë të përhershme ka konfiskuar substancën narkotike të llojit marihuanë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata konform nenit 453 par.1 të KPPK-së, i ka obliguar pandehurit që të paguajn shpenzimet e procedurës penale dhe atë për paushall nga 30 € (tridhjetë euro) dhe në emër të Fondit për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit nga 50 € (pesëdhjetë euro) të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë, në të kundërtën do të urdhërohet përmbarimi i detyruar.

2022:106952

Nga te cekurat me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
2022:064949, datë 6 korrik 2022

Bashkëpunëtori Profesional	**Kryetari i trupit gjykues**
Sali Topalli	Habib Zeqiri

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 dite, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj

2022:106952